

PROMOVIM

Të nderuar kolegë akademikë,

Të çmuar e të dashur të pranishëm,

Sot po promovojmë veprën "Studimet për shqiptarët në Francë", që përmban studimet e mbi 40 autorëve shqiptarë dhe të huaj, të paraqitura në Konferencën shkencore ndërkombëtare të mbajtur në Prishtinë më 29-30 tetor 2021, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Materialet për këtë botim i ka përgatitur akademik Rexhep Ismajli, i cili ishte edhe kryetari i Këshillit përgatitës të kësaj Konference.

Konferenca dhe ky botim janë në vijim të veprimtarive shkencore të ASHAK-ut tashmë të zhvilluara e të botuara për: 1. Studimet albanistike në Amerikë; 2. Studimet albanistike në botën gjermanishtfolëse dhe 3. Studimet albanistike në Itali. Në vitin 2023, po në fund të tetorit, do të mbahet konferenca shkencore e këtij cikli për "Studimet për shqiptarët në Britani të Madhe dhe në Europën Veriore"

Kontaktet e regjistruara të botës shqiptare me botën frënge nisin herët, në shekullin XI, për të vazhduar në sh. XV. Studiues, shkrimtarë e udhëpërshkrues e kanë drejtuar vëmendjen ndaj botës shqiptare në mënyrë më intensive në sh. XIX, e sidomos në sh. XX.

Interesimet për shqiptarët dhe botën e tyre kanë qenë më intensive në kohën pas Skënderbeut, të ndërlidhura me "Historinë e Skënderbeut" të Marin Barletit; pastaj në kohën e Ali Pashë Tepelenës dhe të raporteve të tij me shtetin e Napoleonit; interesime që intensifikohen në valën e romantizmit dhe në fillim të shekullit XX, kur përvijohen konturat e shteteve të reja të Europës, përfshirë Shqipërinë.

Interesimet frënge për Kosovën intensifikohen sidomos kur çështja e Kosovës shtrohet si çështje nacionale dhe politike për zgjidhje, në decenien e fundit të sh. XX: mbështetur në ngjarjet kulturore shqipe të viteve '70; në lëvizjet emancipuese shqiptare të viteve '80 dhe në ngjarjet dramatike politike e luftarake që kulmojnë në fund të viteve '90, me çlirimin e Kosovës.

Le të më lejohet me këtë rast të lexoj sonetin e Pjerr dë Ronsarit për Skënderbeun, të përkthyer në shqip nga Faik Konica, dhe të botuar te revista "Albania" më 1900.

Për veprën "Studimet për shqiptarët në Francë" do të flasim Rexhep Ismajli, Muhamedin Kullashi dhe Nysret Krasniqi.

Në Prishtinë, më 15 qershor 2022

Akademik Sabri Hamiti